



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES SË VEÇANTË TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 9 QERSHOR 2015

SA POSEBNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 9. JUNA 2015. GODINE

QERSHOR - JUNI  
2015

## **Rendi i ditës**

1. Jeta dhe vepra e heroit kombëtar, Isa Boletini.

## **Dnevni red**

1. Život i delo narodnog heroja, Isa Boljetini.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
I nderuar kryeministër,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar mysafirë të pranishëm,  
Mirë se keni ardhur në seancën e veçantë kushtuar jetës dhe veprës së heroit kombëtar, Isa Boletini!

*(Intonimi i himnit)*

Jemi mbledhur sot në këtë seancë të veçantë për ta nderuar figurën e të madhit të kombit tonë Isa Boletini me rastin e rivarrimit të tij.

I gjithë populli i Kosovës dhe ne përfaqësuesit e tij sot jemi krenarë që kemi mundësi për t'i bërë nderime shtetërore këtij personaliteti të madh të lëvizjes sonë kombëtare.

Në një kohë dramatike për popullin tonë, vepra e Isa Boletinit përcaktoi shumë rrjedha të historisë dhe u bë shembull i frymëzimit patriotik për brezat pasardhës, që e trashëguan misionin e çlirimit të Kosovës.

Pas kësaj seance, në hollin e Kuvendit do të mbahen homazhe për Bacën Isë, të cilat janë të hapura, si për institucionet e Kosovës, ashtu edhe për qytetarët tanë.

Në vazhdim do ta kemi nga një fjalë rasti nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Fjalën e ka zoti Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

XHAVIT HALITI: Të nderuar ambasadorë të vendeve mike,  
I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,  
I nderuar kryeministër, Isa Mustafa,  
Të nderuar deputetë,  
Të nderuar ministra,  
Të nderuar familjarë të heroit të kombit, Isa Boletini,  
Të nderuar të pranishëm,  
Të flasësh për një nga figurat më emblematike të kombit shqiptar, Isa Boletini, është nder dhe privilegj i madh.

I ndikuar fuqishëm nga rrethanat e kohës, të cilat popullit shqiptar pakursyeshëm ia kishin imponuar luftën për mbijetesë fizike, njerëzore, kombëtare dhe territoriale, Isa Boletini burrërohet më herët se zakonisht për t'u vënë në shërbim të kombit dhe atdheut.

Në moshën 17-vjeçare, në prill të vitit 1881, merr pjesë në Betejën e Slivovës, ku trupat ushtarake të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 10 qershor 1878 u ndeshën fuqishëm me Ushtrinë Osmane.

Duke qenë i brumosur në frymën politike dhe ushtarake të Lidhjes, Isa Boletini e përkrahu patriotin Haxhi Zeka dhe atdhetarë të tjerë në themelimin e Lidhjes Shqiptare të Pejës, më 1899-1900, dhe qëndresën e saj kundër sunduesve osman dhe qarqeve shoviniste fqinjë.

Edhe gjatë Luftës Ballkanike të vitit 1912, Isa Boletini ishte një ndër krerët më në zë të çetave të Kosovës.

Isa Boletini hyri në historinë shqiptare për kontributin dhe arritjet për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Hyri në histori në një moment historik, por është nga të paktët që i rezistoi gjykimit të historisë. Kurse pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912, vihet në mbrojtje ushtarake që Qeverisë së parë shqiptare, asaj të Ismail Qemalit.

Po ashtu, ishte anëtar i delegacionit shqiptar, që me Ismail Qemalin shkoi në Londër për ta mbrojtur ekzistencën e Shqipërisë të porsakrijuar. Faktikisht, vënia në mbrojtje ushtarake dhe diplomatike e pavarësisë së Shqipërisë shënon aktin kulmor të përkushtimit dhe përpjekjes së heroit tonë në shërbim të kombit.

Jorastësisht, Baca Isë u bë simbol i pashtershëm frymëzimi i gjeneratave të tëra të shqiptarëve në përpjekjet dhe luftën e tyre për çlirim, liri e pavarësi, që kulmuan me luftën çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Të ndodhurit e tij krah Ismail Qemalit, themelimit të pavarësisë së Shqipërisë, e ka mbajtur në këmbë dhe e ka çuar përpara edhe në rrethanat më të rënda të popullit tonë aspiratën për bashkim.

Në të gjitha veprimtaritë e organizuara nga Qeveria, si dhe nëpërmjet kësaj seance të veçantë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, institucionet e shtetit tonë dhe përgjithësisht kombit shqiptar po kryejnë një pjesë të obligimit që kanë ndaj Isa Boletinit, ndaj të kaluarës dhe së ardhmes sonë.

Pjesa tjetër e obligimit tonë, kurorëzimi i së cilës do të rezultojë me integrimin euroatlantik dhe kombëtar të popullit tonë, mbetet për t'u përmbushur me përpjekjet më të koordinuara dhe me përkushtim edhe më të madh mbetet detyrë prioritare e institucioneve të tanishme shtetërore, e institucioneve dhe gjeneratave të ardhshme. Vetëm kështu kombi ynë do ta zërë vendin e merituar në familjet e kombet e qytetëruara. Përmasa kombëtare e Isa Boletinit, përkushtimi i tij madhështor ndaj kombit, si dhe lavdia e tij do t'i mbijetojë shekujt shqiptarë edhe pas 10 qershorit.

Isa Boletini meriton nderimin e gjithë shqiptarëve dhe kam bindjen se vendlindja e tij do të kthehet në faltore për të gjithë shqiptarët në Ballkan. U pefshin në paqe eshtrat tuaj, hero i ynë Isa Boletini! Lavdi!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Haliti! Tani fjalën e ka profesori Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit.

SABRI HAMITI: Zonja dhe zotërinj,  
Kolegë të nderuar,

Mysafirë të çmuar,

Shënjimi i përvjetorit të Isa Boletinit në Kuvendin e Republikës së Kosovës na bën të reflektojmë sot këtu për historinë e trashëgiminë, për ngjarjet e figurat historike, sepse nuk ka kohë zero të një vendi e të një kombi. Kosova në vitet e '60-ta e rizbuloi Gjergj Kastriotin në 500-vjetorin e tij. Kosova në vitet e '70-ta e rizbuloi në 100-vjetor Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, bashkë me të Ymer Prizrenin e Abdyl Frashërin. Po ashtu, ndarjen dhe vetminë 100-vjeçare. Në vitet e '80-ta, Kosova e zbuloi vetveten dhe kryengritjen. Në vitet e '90-ta, Kosova enjohu vetveten, domosdoshmërinë e lirisë e të pavarësisë dhe të luftës për liri.

Ftoi njohje dhe bota nëpërmjet Ibrahim Rugovës dhe Adem Jasharit. Në vitet 2000 ,Kosova u shpall dhe u njoh e pavarur në 100-vjetorin e alfabetit shqip dhe në prag të 100-vjetorit pavarësisë së Shqipërisë, duke kujtuar Ismail Qemal Vlorën dhe Isa Boletinin.

Kujtimi i ikonave shqiptare të lidhura njëra me tjetrën, të cilat në mbiemër mbajnë vende e krahina shqiptare, në kohë e në hapësirë, na nxjerrin përpara, mbi të gjitha, sintaksën shqiptare që lidh mendimin dhe veprimin për ta krijuar identitetin kombëtar si vetëdije e si histori, një trashëgimi që kapërcen breza e kapërcen shekuj.

Sot që po e shënjojmë njëqindvjetorin e Isa Boletinit, duke i kthyer eshtrat e tij në vendlindje, në Boletin, lejohet që të kalohet nga kujtesa historike në kujtesë poetike, duke pasur vetëdijen që Isa Boletini ishte këtu përgjithmonë.

#### ISA BOLETINI

Fliste. Flitnin. I dëgjonte,  
Isa me sy plot mall  
Maste largësitë e Dheut.

Me gishta të trashë  
Shkruante hartën e re  
Në dheun e kuq të udhës,  
Isa me sy të përmalluar  
Maste largësitë e At-Dheut.

Tymi le të dalë në Llap  
Kur nën lisa bie dushku  
Të çohet flakë përnjëherë  
Në Kaçanik, në Carralevë.  
Isa me sy të përmallshëm  
Shihte udhët që ngjiteshin.

Flaka nis zihet e rritet  
Kur dushku bie ndër Lisa  
Zjarri e djeg mustakun  
Në sy ziente lotin Isa  
E vargu i shtruar me plisa  
E zbrit udhën në një.

Isa me sy të përballshëm  
Maste gjerësitë e Dheut  
Këmbët ngulte në Gur  
Kur shkelte në Flamë-Urë  
I drejtë si një Flamur.

E tirrte mallin Isa  
Në flakë digjej shtëpia  
Kur dushku bie nën Lisa  
E rruga shtrohet me plisa  
Me gisht krijonte hartën  
Po gishti pikonte gjak.

Nuk herret mali me shpatë  
Nuk shkelet deti me kalë  
Nuk shuhet malli me valë  
Në udhën e shkretë në natë.  
Kur shkeli në Flamë-Urë  
I drejtë si një Flamur.

Një dorë në zemër një në flakë  
E shkundi malin fryu fushat.  
Masha ia mati shtatin!  
Kur tha se vdiq keq tjerr fatin,  
Me lot me rrenat e Dheut  
Mat gjerësinë e At-Dheut.

Prishtinë, 1981 - Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Profesor! Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: E nderuara familje Boletini,  
Të dashur qytetarë,  
Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
Isa Boletini është një prej figurave qendrore të pavarësisë shqiptare. Ai, së bashku me Ismail Qemalin, Hasan Prishtinën, Bajram Currin, Luigj Gurakuqin e Idriz Seferin e vazhduan rrugën e Abdyl Frashërit e Ymer Prizrenit për lirinë tonë kombëtare kundër shtypjes osmane.

Por, figurat tona të mëdha kombëtare nuk janë thjesht që t'i nderojmë vetëm sa për t'i varrosur në panteonin e lavdishëm të historisë. Isa Boletini është aktual, jo muzeal. Vlerat e tij janë udhërrëfyes për këdo që merr përsipër përgjegjësi publike për kombin.

Së pari është atdhedashuria e pakushtëzuar. Isa Boletini nuk e shihte kombin nëpërmjet vetvetes, por veten e tij nëpërmjet kombit. Fati i tij personal është singular me fatin e kombit shqiptar. “Unë jam mirë kur asht mirë Shqypnia”, i tha ai Ibrahim Pashës, pasi ai ia bëri disa premtime për

pasuri dhe për poste, duke i thënë që mund t'ia bënte jetën e tij personale shumë më të mirë sesa e kishte. Por, ai tha: “Jo, faleminderit! Unë jam mirë kur asht mirë Shqypnia”.

Pra, kombi im është kushti i jetës sime, e jo e kundërta. Kur i mbështeti xhonturqit kundër Sulltan Hamitit, ai këtë e bëri sepse bashkë me Hasan Prishtinën mendonin se kjo do të sillte më shumë liri e të drejta për shqiptarët. Por, kur doli e kundërta, ata nuk u ndalën. Luftën më të madhe e bën pikërisht kundër ‘turqve të rinj’, sepse shtypja kundër shqiptarëve nuk u hoq.

Së dyti është guximi i tij i paepur. Isa Boletini ka qenë i pathyeshëm. Ai ishte një prej komandantëve të Gardës së Sulltanit, por u pajtua me rrëzimin e tij, vetëm që për shqiptarët të bëhej më mirë. Asnjë privilegj, asnjë post, asnjë favor, asnjë pasuri e premtuar nuk e lëkundi Isa Boletinin që ta hidhte qoftë një hap të vetëm kundër popullit të vet.

Kur xhonturqit ia zunë peng dy djemtë e tij në Selanik dhe i thanë që të dorëzohej, ai tha: “Jo vetëm këta dy, por nëntë djemtë e mi nuk i kam bërë për vete, por për lirinë e Shqipërisë”. Kjo do të thotë që jo vetëm veten, por gjithë familjen e farefisin, Isa Boletini e vendosi në tehun e sakrificës kolektive për lirinë e kombit. Nuk është se nuk iu dhimbën djemtë. Të gjithëve u dhimben fëmijët e vet. Nuk është se ishte pa ndjenja. Por, se ishte thelbi i njeriut: ta mohosh veten dhe familjen për ta pohuar kombin.

Pasardhësi i drejtpërdrejtë i Isa Boletinit është Adem Jashari. Familjet e tilla dhe personalitete si Isa Boletini e Adem Jashari bëhen leva të Arkimit për lirinë e një kombi të tërë.

Së treti është modestia dhe refuzimi kategorik që të përfitosh personalisht nga liria e kombit. Kur Ismail Qemali i kërkoi Isa Boletinit të bëhej ministër në Qeverinë shqiptare, ky i fundit i tha se ka njerëz edhe më të shkolluar. Ai, pra, nuk e shihte lirinë e kombit të vet si një mundësi për vete, para së gjithash. Kur hyri në Vlorë dhe e puthi flamurin kuqezi të pavarësisë, zemra iu mbush plot dhe me kaq u mjaftua për vete. Pavarësia nuk mbahet me privilegje vetjake, por vetëm me sakrificë të vazhdueshme personale që ajo të mund të qëndrojë. E nesërmja e pavarësisë, atë e gjeti në Shkodër, duke e mbrojtur atë nga Mali i Zi, në Malësinë e Gjakovës, apo në Durrës, në një luftë tjetër kundër xhonturqve. Të vegjël janë ata që mendojnë për poste, kur kombi ka nevojë për mbrojtje.

Zonja dhe zotërinj,

Isa me të drejtë po varroset në Boletin. Por, do të jetë i qetë vetëm atëherë kur mbi kalanë e Zveçanit të valojë flamuri kuqezi, e jo ai i Serbisë. Dhe, vetëm atëherë kur Mitrovica, të cilën ai aq shumë e dëshironte dhe për të cilën luftoi, të bashkohet.

Isa Boletini nuk do të prehet i qetë, nëse varri dhe kulla e tij përfundojnë në “Zajednicën serbe”, të cilën po e krijojnë pikërisht këta që po i thurin lavde.

Lavdi e përjetshme jetës dhe veprës së heroit tonë kombëtar, Isa Boletini!

KRYETARI: Faleminderit! Ramush Haradinaj e ka fjalën.

RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit,

Kryesi,  
I nderuar kryeministër,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar deputetë,  
Mysafirë të pranishëm,  
Të nderuar qytetarë,  
Nëse në historinë tonë kombëtare kërkojmë vlera atdhetare, por edhe humanizmin dhe respektin për shtet dhe identitet kombëtar, atëherë këto vlera padyshim se i gjejmë në figurën e Isa Boletinit.

Vepra e Isës si për së gjalli, ashtu edhe tani, e ka një simbolikë të fuqishme, që konsiston në idenë e të qenët bashkë nga të gjitha trevat shqiptare, por edhe më gjerë, pa dallime dhe ngjyrimë partiake e politike. Madje, Isa veten e identifikoi me fatin e atdheut, duke u shprehur burrërisht se ai ishte mirë kur ishte mirë Shqipëria.

Isa jetoi dhe veproi në kohën kur qenia kombëtare e territoriale e shqiptarëve u rrezikua shumë seriozisht. Kryengritjet në Kosovë e më gjerë, të udhëhequra nga ai, e patën një jehonë të madhe dhe e përgatitën terrenin për pavarësimin e Shqipërisë. E nëse Isa gjatë jetës e la një porosi, atëherë këtë gjë po e bën edhe tani. Ai po i kthehet vendlindjes me porosi se atdheu nuk tjetërsohet, nuk vihet në pazar dhe roje e dëshmi do të jetë vetë prehja e tij në Boletin.

Prehja e eshtrave të Isa Boletinit në vendlindje imponohet edhe nga fakti se varri i tij ishte mbajtur sekret rreth 70 vjet nga pushtetet e mëhershme i pashënuar, me qëllim të zhdukjes së çdo gjurmë të këtij trimi dhe bashkëluftëtarëve të tij, andaj ky akt është një borxh i dyfishtë yni ndaj këtij heroi.

Figura e Isës, edhe tani 99, vjet pas vdekjes, le të jetë shembull për të gjithë se si interesi kombëtar e shtetëror vendoset para çdo interesi tjetër.

Lavdi dhe u preftë i qetë për jetë e mot!

**KRYETARI: Faleminderit! Valdete Bajrami e ka fjalën!**

**VALDETE BAJRAMI: Faleminderit!**

Të nderuar të pranishëm,

E nderuara familje Boletini dhe ju mysafirë të nderuar!

Sot, pak muaj pa u mbushur 100 vjet, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, kryetrimt shqiptar të Kosovës, Isa Boletini, po ia bëjmë nderimin e merituar, për të cilin nderim heroi i ynë dhe populli ynë pritën një shekull.

Për të ardhur te ky moment u deshën shumë përpjekje, shumë flijime, shumë ngritje e rënie të disa brezave, prej të cilëve brezi ynë, pas atij të UÇK-së, po rezulton të jetë më fatlumi, pasi vite më parë ia hapi rrugën e ardhjes në Kosovë kryeheroit të shqiptarëve Skënderbeut, pak para disa ditëve flamurtarit të pavarësisë së Shqipërisë, Ismail Qemali, e tani edhe fatosit të kryengritjeve shqiptare të viteve 1910-1912, Isa Boletini.



Qytetarë të nderuar të Kosovës,  
Shqiptarë, kudo që jeni!

Isa Boletini, atdhedashurinë e tij do ta tregojë në vitet e lavdishme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kur si minoreni mori pushkën për t'iu bashkuar luftëtarëve të saj. Luftëtarët kombëtarë do ta kursejnë shaljanin e ri nga Boletini dhe nuk u gabuan.

Nuk do të vonojë kur ai për dekada do të bëhet njëri nga udhëheqësit më me integritet i të gjitha besëlidhjeve shqiptare, njëri nga drejtuesit e luftëtarëve më të pakompromis të të gjitha kryengritjeve shqiptare për çlirim, për autonomi e pavarësi të shqiptarëve e të Shqipërisë.

Në ditët më të vështira të popullit shqiptar, në fillimshkullin XX, në ditët që e bënë të lavdishëm shekullin e pavarësisë së Shqipërisë, ishte krah për krah Ismail Qemalit, Hasan Prishtinës, Luigj Gurakuqit, Bajo e Çerçiz Topullit, Bajram Currit e luftëtarëve të tjerë të mëdhenj të kombit, të burrave me integritet që e nisën epokën e epokave të shqiptarëve - epokën e pavarësisë së Shqipërisë.

Edhe sot, nga kjo foltore e Kuvendit të Kosovës, atyre burrave të kombit ua përcjellim nderimet tona të përjetshme, të sinqerta e bujare.

Isa Boletini lindi më 15 janar 1864, në fshatin Boletin, i cili shtrihet në pjesën veriore të Mitrovicës, aty ku familja Boletini kishte shtëpi e katandi, e kishte kullën me bedena që e therte qiellin, e cila armiqve të Shqipërisë u bënte karshillëk dhe për të atdheun ishte roje nderi dhe llogore lufte.

Në një ambient tej atdhetar kur tregoheshin legjenda për trimërinë tradicionale shqiptare, ku thureshin e bëheshin legjendat, ku tregoheshin bëmat e Skënderbeut, të Gjergj Elez Alisë, Abdyl Frashërit, Sylejman Vokshit, Mic Sokolit, Sefë Kosharës, Ali Ibrës, Jakup Ferrit, u rrit e u edukua shtatlarti i Boletinit, që edhe për jetën e veprën e tij u thurën mite e legjenda.

Vetëm kjo formë e të mësuarit të historisë nëpërmjet miteve e legjendave, popujve të robëruar e të paarsimuar, siç ishte edhe populli ynë, u ka mundësuar të kapërcejnë shekuj e ta ruajnë me integritet identitetin e tyre, etninë, gjuhën, kulturën, traditën e tyre të përcjellë brez pas brezi.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit për shqiptarët, kudo që ishin, po e hapte një epokë të re, epokën e shqiptarizmit, jo vetëm për një komb, për një gjuhë, shkollë e atdhe të përbashkët, por edhe për një shtet të shqiptarëve, Shqipërinë.

Idetë që i formoi e i kristalizoi shekulli XIX nëpërmjet mendjeve të ndritura të Rilindjes Kombëtare, duhej t'i vazhdonte, finalizonte e formalizonte shekulli XX dhe për këtë populli shqiptar i kishte bërë përgatitjet e shumanshme, e mbi të gjitha historia njëshekullore i kishte përgatitur drejtuesit dhe luftëtarët e integritetit të lartë kombëtar e atdhetar, luftëtarët e pavarësisë së Shqipërisë. Një nga këta luftëtarë, me identitetin dhe integritetin e tij të paluhatshëm e të pakompromis, pa dyshim se ishte luftëtari nga Boletini.

Isa Boletinin jeta e kishte mësuar për t'u përballur me furtuna e vështirësitë e jetës, jeta e kishte bindur se nderi, liria, lavdia e kanë çmimin të shtrenjtë, tepër të shtrenjtë, sa për këto gjëra të çmuara njerëzore që shërbejnë e vihen në shërbim të brezave ia vlen të bëhet çdo flijim njerëzor.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar bashkëkombës kudo që jeni,

Edhe sot, sikur para 100 vjetëve, Kosovës i duhet urtia e rilindësve tanë të urtë. Na duhet shqiptarizmi si fe e atdhe, ajo që na bëri strehën e përjetshme në Evropën pellazge, na duhet dashuria e integritetit për komb e atdhe, na duhet guximi i lëvizjes kombëtare për çlirim, i asaj lëvizje që lindi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe komandantin legjendar, Adem Jashari.

Janë këta breza që na brumosën me dashuri për lirinë e pavarësinë, që sot i kemi. Respekti për këta breza, që nuk kursyen asgjë për komb e atdhe, respekti për Isa Boletinin na bëri që, duke e nderuar kryeherin e kryengritjeve shqiptare, ta nderojmë qershorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe qershorin e lirisë së Kosovës.

Lavdi e përjetshme heroit të kombit, Isa Boletini! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar të pranishëm, ju falënderoj për pjesëmarrjen, me çka edhe i përmbyll punimet e kësaj seance kushtuar jetës dhe veprës së heroit kombëtar, Isa Boletini.

Edhe një njoftim: nga ora 14:00 deri në orën 17:45, eshtrat e heroit kombëtar do të jenë në hollin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për homazhe. Faleminderit!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*